



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më . . . 2020

PLATFORMË VLERËSIMI

A. QËLLIMI

Vlerësimi i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), për masat e marra për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar.

B. BAZA LIGJORE

1. Ligji nr. 69, datë 21.06.2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
3. Udhëzim nr. 26, datë 25.11.2019 për “Kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.
4. Udhëzimi nr.13, datë 22.05.2019, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.
5. Udhëzimi i përbashkët, MASR dhe MFE, nr. 18, datë 18.08.2019, “Për vitin shkollor 2019-2020, në sistemin arsimor parauniversitar”.

C. DREJTIMET E VLERËSIMIT

- ZVAP-ja ka siguruar arsimimin e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuar (AK), në përputhje me nevojat e tyre.

D. METODOLOGJIA

- Takim me drejtuesin e ZVAP-së dhe Komisionin Multidisiplinar të ngritur pranë ZVAP-së.
- Studimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit.
- Takim përmbyllës me drejtuesin e ZVAP-së dhe Komisionin Multidisiplinar të ngritur pranë ZVAP-së.

E. INSTITUCIONI QË DO TË VLERËSOHET

- ZVAP-ja “.....”

F. KOHA E REALIZIMIT TË VLERËSIMIT

- __-__-__.2020

G. PËRBËRJA E EKIPIT TË VLERËSIMIT

1. drejtues/e ekipi
2. anëtar/e

H. RAPORTI I VLERËSIMIT DO T’I DORËZOHET

- Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
- Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar
- Drejtorisë Rajonale Arsimore Parauniversitare
- Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare të vlerësuar.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

GERTI JANAQI

ANEKS**TREGUESIT E VLERËSIMIT**

Qëllimi: Vlerësimi i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), për masat e marra për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar.

ZVAP: _____

DRAP: _____

Ju lutem, shënoni me X zgjedhjen tuaj në kutizën përkatëse. Nëse ju mendoni se është e nevojshme, bëni komente për zgjedhjen.

TREGUESIT	PËRSHKRUESIT PRAKTIKË	NIVELET E VLERËSIMIT				KOMENTE
		1	2	3	4	
1.ZVAP-ja ka siguruar arsimimin e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuar, në përputhje me nevojat e tyre.	1.1. ZVAP-ja ka ngritur Komisionin Multidisiplinar për fëmijët me AK, në përputhje me kriteret zyrtare.					
	1.2. ZVAP-ja, në bazë të numrit të IA-ve që mbulon dhe në bazë të numrit të nxënësve me AK, ka ngritur më shumë se një komision, për mbulimin në kohë të nevojave për vlerësim.					
	1.3. Komisioni Multidisiplinar ka vlerësuar shkallën e vështirësive të çdo nxënësi, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur nga prindi/kujdestari ligjor apo nga institucioni arsimor.					
	1.3. Komisioni Multidisiplinar është mbledhur tri herë në vit, përkatësisht: para fillimit të vitit shkollor, në fund të periudhës së parë dhe në fund të vitit mësimor.					
	1.4. Komisioni Multidisiplinar ka përcaktuar: <ul style="list-style-type: none"> - nevojat arsimore të nxënësit; - nevojën për mësues ndihmës në klasë; - nevojën për mësues ndihmës në shtëpi; - numrin e orëve mësimore të nevojshme për çdo nxënësi me AK, duke e shënuar atë në dosjen e vlerësimit. 					
	1.5. Komisioni Multidisiplinar pas çdovlerësimi (një herë në vit) ka bërë vlerësimin e nevojës së nxënësit për mësues ndihmës.					
1.6. Komisioni Multidisiplinar ka: <ul style="list-style-type: none"> - njoftuar personin që ushtron përgjegjësinë prindërore për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës; 						

	<ul style="list-style-type: none"> - dhënë me shkrim personit që ka paraqitur kërkesën, rekomandimin për ndjekjen nga fëmija të shkollës së zakonshme ose të specializuar, ose kalimin nga shkolla e specializuar në shkollën e zakonshme dhe anasjelltas; - rekomanduar shërbimet shtesë që duhet të marrë fëmija në qendra ditore ose në institucione të tjera të specializuara për shërbimet rehabilituese; - rekomanduar pajisjen e fëmijës me raportin mjeko-ligjor, kur fëmija nuk e ka. 						
	<p>1.7. Komisioni Multidisiplinar, për vlerësimin e nxënësve dhe për praktikat e punës, është mbështetur në klasifikimin ndërkombëtar të funksionimit të aftësisë së kufizuar dhe shëndetit.</p>						
	<p>1.8. Komisioni Multidisiplinar ka ftuar të paktën njërin prind (ose kur nuk është e mundur një të afërm) gjatë vlerësimit të fëmijës, si dhe kur fëmija është në kopsht/shkollë edhe punonjësin e shërbimit psiko-social të IA-së dhe mësuesin e fëmijës të caktuar nga drejtori i IA-së.</p>						
	<p>1.9. Komisioni Multidisiplinar ka rekomanduar ndjekjen e shkollës së specializuar vetëm kur ka gjykuar se, ndjekja e shkollës së zakonshme nuk do të zhvillonte sa duhet fëmijën me AK.</p>						
	<p>1.10. Komisioni Multidisiplinar ka njoftuar me shkrim drejtorin e institucionit të zakonshëm arsimor se cilët nga fëmijët me AK do të mësojnë me plan mësimor dhe programet lëndore të zakonshme, të përshtatura ose individuale, si dhe mjetet ndihmëse që i nevojiten për të realizuar procesin mësimor-edukativ.</p>						
	<p>1.11. Komisioni Multidisiplinar ka udhëzuar komisionet e IA-ve për punën me nxënësit me AK.</p>						
	<p>1.12. Komisioni Multidisiplinar disponon dokumentacionin fillestar të fëmijës me AK, të cilin e përditëson me ecurinë e tij në bashkëpunim me komisionin e IA-së.</p>						
	<p>1.13. ZVAP-ja ka siguruar kushtet e përshtatshme për ushtrimin e punës së Komisionit Multidisiplinar.</p>						
	<p>1.14. ZVAP-ja i ka vënë në dispozicion Komisionit Multidisiplinar dokumentacionin e fëmijëve që do të vlerësojë, të paktën dy javë para vlerësimit.</p>						
	<p>1.15. ZVAP-ja ka kryer procedurat e përzgjedhjes së mësuesit ndihmës, në përputhje me udhëzimin për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.</p>						
	<p>1.16. ZVAP-ja ka caktuar mësuesin ndihmës për fëmijët me AK, sipas nevojave individuale të tyre, bazuar në rekomandimin e Komisionit Multidisiplinar.</p>						
	<p>1.17. Mësuesit ndihmës për nxënësit me AK plotësojnë kriteret e përcaktuara në udhëzimin zyrtar.</p>						
	<p>1.18. ZVAP-ja ka informuar IA-të publike për shërbimet rehabilituese që ofrohen nga institucionet shtetërore shëndetësore.</p>						

	1.19. ZVAP-ja ka pajisur me përparësi nxënësit me AK me mjete mësimore dhe pajisje ndihmëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe zhvillimin e tyre personal e ndërpersonal.					
	1.20. ZVAP-ja ka organizuar, nëpërmjet NjShPS-së, bashkëpunimin e mësuesve të shkollave të specializuara, me mësuesit e shkollave të zakonshme, për hartimin dhe vënien në jetë të planeve edukative (PEI) për nxënësit me AK.					

Ekipi i vlerësimit

.....
.....

Drejtori i shkollës